

E L James

Pesëdhjetë Hijet e Greit

Roman

Përktheu nga origjinali: M B Bako

Botimet
DRITAN
Tirana

Titulli i originalit: Fifty Shades of Grey, E L James.

First published by The Writer's Coffee Shop Publishing House,
Australia, 2011

Copyright © 2011, Fifty Shades Ltd.

The author published an earlier serialized version of this story online with different characters as *Master of Universe* under the pseudonym Snowqueen's Icedragon.

© Për Përkthimin: Botimet DRITAN – TIRANË.

ISBN: 978-99956-21-75-9

Redaktoi: Vladimir Bako

Dritan Editions - Tirana
Bulevardi "Bajram Curri", Aviacioni i Ri, 7/51,
Tirana, Albania.
Tel.&Fax: 00355 4 222 40 44
Tel.: 00355 4 224 57 09
E-mail: botimetdritan@gmail.com

Pesëdhjetë Hijet e Greit

E L James është ish-drejtuese televizioni, bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve e banon në Londrën Perëndimore. Qysh në fëmijërinë e hershme, ajo ëndërronte të shkruante histori, me të cilat lexuesit do të binin në dashuri, po këto ëndrra do t'i linte në pritje për t'u përqendruar te familja dhe karriera. Më në fund, mori kurajën të vinte penën mbi letër me romanin e saj të parë “Pesëdhjetë Hijet e Greit”. Ajo është, gjithashtu, autorja e romaneve “Pesëdhjetë Hije më të Errëta” dhe “Pesëdhjetë Hije të Çliruara”.

LIBRA NGA E L JAMES

Pesëdhjetë Hijet e Greit
Pesëdhjetë Hije më të Errëta
Pesëdhjetë Hije të Çliruara.

*Për Niall,
zotin e universit tim*

FALËNDERIME

U jam në borxh njerëzve të mëposhtëm për ndihmën dhe mbështetjen e tyre:

Bashkëshorti im, Niall, faleminderit që durove maninë time, që u bëre hyjni shtëpiake dhe bëre redaktimin e parë.

Shefja ime, Linda, faleminderit që më durove gjithë vitin e shkuar, ndërkohë që merresha me këtë çmenduri.

CCL, pa ta zbuluar identitetin, po të falënderoj.

Original bunker babes, faleminderit për miqësinë dhe mbështetjen tuaj të pandërprerë.

SR, faleminderit për këshillat e dobishme që në krye të herës.

Sue Malone, faleminderit që më ftillove.

Amanda dhe të gjithë ju në TWCS, faleminderit që vutë bast për mua.

KAPITULLI NJË

Ngrysem e irrituar para vetes në pasqyrë. Dreqi i marrtë këta flokë... që nuk shtrohen dhe dreqi e marrtë Kethrinë. Kevënanë që u sëmur dhe ma ngeci mua këtë sprovvë. Duhej të isha duke studiuar për provimet e fundit, të cilat i kam javën e ardhshme; përkundrazi, ja tek jam, duke u orvatur të nënshtroj flokët e mia. *Nuk duhet të fle me flokë të lagura. Nuk duhet të fle me flokë të lagura.* Duke përsëritur këtë mantra disa herë, rrekem, edhe një herë, t'i vë nën kontroll me furçë. Rrotulloj sytë e nervozuar dhe vështroj ngultas vajzën e zbehtë me flokët gështenjë dhe sytë blu tepër të mëdhenj për fytyrën e saj, që më sheh, po ngultas, nga pasqyra. Dorëzohem. E vetmja alternativë është t'i mbledh flokët e pabindur bisht kali dhe të shpresoj të dukem gjysmë e prezantueshme.

Kejti është shoqja ime e banesës dhe zgjodhi pikërisht sot t'i dorëzohej gripit. Kësisoj, nuk mund ta bëjë intervistën që kishte planifikuar me një manjat mega-industrialist, të cilit nuk ia kisha dëgjuar ndonjëherë emrin, për gazetën studentore. Ndaj dola unë vullnetare. Duhet t'u futem me kokë studimeve për provimet finale dhe kam për të përfunduar edhe një ese, për të cilën mendohej të punoja sot mbasdite, por jo... sot jam e detyruar t'i jap makinës për 165 milje deri në qendër të Siatëllit për të intervistuar këtë drejtorin ekzekutiv enigmatik të Ndërmarrjeve Grei Holldings. Si sipërmarrës i jashtëzakonshëm dhe sponsor i rëndësishëm i universitetit tonë, koha e tij është jashtëzakonisht e çmuar (fort më e çmuar se e imja), megjithatë i ka akorduar Kejtit të drejtën e një interviste. Një sukses i vërtetë, më thotë ajo. Në djall vafshin edhe aktivitetet e saj jashtëshkollore.

Kejti është mbledhur kruspull në divanin e dhomës së ndenjjes.

– Ana, më vjen keq. M'u deshën nëntë muaj ta siguroja këtë intervistë. Do të më lypsen gjashtë muaj të tjerë për ta planifikuar përsëri e ndërkohë ne të dyja do të jemi diplomuar deri atëherë. Si botuese e gazetës, nuk mund ta lë të më fluturojë ky rast. Të lutem, – më lutet Kejti me zërin e ngjirur, që i del nga gryka e pezmatuar. Si ia bën ajo vajzë? Edhe e sëmurë, duket e këndshme dhe vocërrake, me flokë të rregullt biondë në të kuq dhe sy të shkëlqyeshëm jeshilë, ndonëse tani i ka me rrathë të kuq dhe të lëngshëm. E injoroj këtë sëmbim dhembshurie të paftuar.

– Sigurisht që do të shkoj, Kejt. Ti duhet të kthehesh në shtrat. Dëshiron ndonjë *NajKil* apo *Tajlëno*?

– *NajKil*, të lutem. Ja pyetjet e mia dhe regjistruesi dixhital. Shtyp vetëm *Regjistro* këtu. Mbaj shënime; do t'i hedh unë pastaj të gjitha në të pastër.

– Unë nuk di asgjë për të, – mërmëris, duke u përpjekur më kot të shtyp panikun që po më shtohet.

– Të ndihmojnë pyetjet. Nisu. Është rrugë e gjatë. Nuk dua të bëhesh vonë.

– Në rregull, po nisem. Kthehu në shtrat. Të bëra një supë që ta ngrohësh më vonë. – E vështroj me dashuri. *Vetëm për ty, Kejt, do ta bëja këtë.*

– Do të shtrihem. Paç fat. Dhe faleminderit, Ana... si zakonisht, ti më shpëton jetën.

Duke marrë çantën e shpinës, i buzëqesh me zor, pastaj dal nga dera dhe drejtohem për nga makina. Nuk arrij ta besoj që Kejti ma mbushi mendjen ta bëja këtë. Mirëpo Kejti mund t'ia mbushë mendjen kujt do për çdo gjë. Do të bëhet gazetare e jashtëzakonshme. Është e gojës, e fortë, bindëse, argumentuese, e bukur... dhe është shoqja ime më e dashur, më e dashur.

RRUGËT JANË TË LIRA ndërsa nisem nga Vankuveri, Uashington drejt *Autostradës Ndërshtetërore 5*. Është herët dhe nuk lypset të jem në Siatëll deri në orën dy të kësaj pasditeje. Për fat, Kejti më ka dhënë hua *Mercedesin* e saj sportiv *CLK*. Nuk jam e sigurt nëse *Uanda*, volkswageni im *Brumbull*, do ta bënte

rrugën në kohë. Oh, me *Mercedes* është qejf të udhëtosh dhe miljet fluturojnë ndërsa shtyp pedalin deri në fund.

Vendmbërritja ime janë zyrat qendrore të ndërmarjes globale të zotit Grei. Është një ndërtesë zyrash e stërmadhe njëzetkatëshe, e gjitha me çelik dhe xham të lakuar, një fantazi utilitare arkitekti, me germat GODINA GREI të shkruara thjesht me çelik mbi portën kryesore prej xhami. Është dymbëdhjetë pa një çerek kur mbërrij, e lehtësuar së tepërmi që nuk jam vonë, ndërsa hyj në hollin e stërmadh... dhe sinjerisht të frikshëm.... prej xhami, çeliku dhe guri të bardhë ranor.

Prapa skrivanisë prej guri solid, një grua e re bionde, fort tërheqëse, e mbajtur, më buzëqesh përzemërsisht. Mban veshur xhakëtë në ngjyrë qymyri dhe këmishën e bardhë më fine që më kanë zënë sytë ndonjëherë. Duket e pacen.

– Kam ardhur të takoj zotin Grei. Jam Anastasia Still për Kethrinë Kevënanë.

– Më falni një çast, zonjusha Still. – Ajo ngre vetullat ndërkohë që unë qëndroj e druajtur përballë saj. Po filloj të mendoj se do të kishte qenë më mirë të kisha veshur një nga xhaketat zyrtare të Kejtit në vend të xhakëtës sime në ngjyrë blu marine të përdorur shumë herë. Kam marrë mundimin të vesh fundin tim të vetëm, çizmet e mia të spikatura bojëkafe deri te gjuri dhe një pulovër blu. Për mua, kjo do të thotë të vishesh me elegancë. Fut pas veshit një dredhë flokësh që i ka shpëtuar bishtit ndërsa hiqem sikur ajo nuk më fut frikën.

– Zonjusha Kevëna pritët. Ju lutem, firmosni këtu, zonjusha Still. Do të merrni ashensorin e fundit në të djathtë dhe do të shtypni butonin e katit të njëzetë. – Më buzëqesh me mirësjellje, e zbavitur, pa dyshim, ndërsa firmos.

Më zgjat një lejekalimi sigurie, që ka të stampuar mbi të fjalën “vizitor”. Nuk e mbaj dot një buzëqeshje vetëkënaqësie. Sigurisht është e dukshme që jam vizitore. Unë nuk përshtatem me këtë vend. *Asgjë nuk ndryshon*. Psherëtij së brendshmi. Duke e falënderuar, shkoj drejt ashensorëve dhe kaloj dy burra të shërbimit të sigurimit, të cilët janë veshur goxha më elegantë se unë me kostumet e zeza të prera bukur.

Ashensori më fluturon me shpejtësi të skajshme në katin e

njëzetë. Dyert hapen dhe gjendem në një tjetër sallon të madh... përsëri gjithçka prej xhami, çeliku dhe guri të bardhë ranor. Përballem me një skrivani tjetër prej guri ranor dhe një tjetër grua të re bionde, këtë herë e veshur përsosmërisht bardhë e zi, e cila ngrihet të më mirëpresë.

– Zonjusha Still, mund të prisni këtu, ju lutem? – Më tregon një vend me karrige lëkure të bardha.

Prapa karrigeve të bardha është një dhomë e madhe takimesh prej muresh xhami me një tryezë po aq të madhe druri të errët dhe me të paktën njëzet karrige të ngjashme përreth. Përtej asaj, ndodhet një dritare nga dyshemeja në tavan me një pamje të horizontit të Siatëllit, që vështron përmes qytetit në drejtim të Saundit. Është një pamje magjepsëse dhe për një çast shushatem prej saj. *Uau!*

Ulem, nxjerr pyetjet nga çanta e shpinës dhe u hedh një sy, duke sharë me vete Kejtin që nuk më kishte futur një biografi të shkurtër. Nuk di kurrëgjë për këtë burrë që do të intervistoj. Mund të jetë nëntëdhjetë ose tridhjetë vjeç. Pasiguria më nxeh dhe nervat më ngrihen në sipërfaqe, duke bërë të mos të mbajë vendi. Nuk jam ndier kurrë rehat me intervistat një-me-një, duke parapëlqyer anonimitetin e një diskutimi në grup, ku mund të ulem pa rënë në sy në pjesën e pasme të sallës. Sinqerisht, parapëlqej të jem vetëm, duke lexuar një roman klasik të letërsisë angleze, e kruspullosur në një karrige në bibliotekën e kampusit. Jo të rri ulur dhe të dridhem me nervozizëm në një ngrehinë kolosale prej xhami dhe guri.

I rrotulloj sytë vetes sime. *Mblidhe veten, Still*. Duke gjykuar nga ndërtesa, e cila është tepër klinike dhe moderne, ma ha mendja që Grei është te të dyzetat, me flokë të çelët, si personeli.

Një bionde tjetër elegante, veshur me përsosmëri, del nga një derë e madhe në të djathtë. Si është puna me gjithë këto bionde që s'kanë të sharë? Këtu qenka si në *Stepfërd*. Marr frymë thellë dhe ngrihem.

– Zonjusha Still? – pyet biondja më e fundit.

– Po, – kuak unë dhe kruaj fytyrën. – Po. – Ja, kjo u duk më e sigurt.

– Zoti Grei do t'ju presë pas pak. Mund ta marr xhaketën